



REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Government of Kosovo / Government of Kosovo / Government of Kosovo	
Ministry of Finance / Ministry of Finance / Ministry of Finance	
Tax Administration of Kosovo / Tax Administration of Kosovo / Tax Administration of Kosovo	
Nr. i Org. Org. Jedin. Org. unit	2.2
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	09-06-4400
Nr. i fazeve Broj stranica Hy/E50	-
Data Datum Date	26.12.18



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

## VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01/2018 PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË FONDIT REZERVË TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE, TË LICENCUARA NGA BQK

### QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik, është që të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave për fondin rezervë të institucioneve financiare, të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

### BAZA LIGJORE

Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-113, si dhe neni 13 i Ligjit Nr.03/L-162 dhe Ligjit NR. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, përcakton fondet rezervë, citojmë:

- 1. Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë ligj, kontributet në fondet rezervë nuk lejohen si shpenzime.*
- 2. Institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës, ndryshe nga ato të ardhura që dalin nga sigurimi i jetës, pasurisë, apo rreziqeve tjera, kanë të drejtë në shpenzime për krijimin e fondit të posaçëm rezervë për mjetet e dyshimta të tyre në shumën e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejueshme nga Banka Qendrore e Kosovës.*
- 3. Nëse një institucion financiar është i angazhuar edhe në aktivitete bankare edhe në ato të sigurimit, shpenzimet për fondin rezervë janë të lejueshme vetëm në raport me mjetet e dyshimta që dalin nga aktivitetet bankare.*
- 4. Pas krijimit të fondit të posaçëm rezervë, çdo shumë e tërhequr prej fondit duhet të përfshihet në të ardhura dhe në çdo shumë të kthyer në fond për ta rimbushur atë deri në shumën e lejueshme që lejohet si zbritje."*

## TRAJTIMI TATIMOR I FONDIT REZERVË

Për qëllime tatimore, fondi i posaçëm rezervë lejohet shpenzim vetëm në raport me mjetet e dyshimta – rrezikut kreditor që dalin nga aktivitetet bankare, deri në shumën maksimale të lejuar nga BQK.

Bazuar në sqarimet e dhëna nga BQK (përmes Dokumentit nr. 306-D-2018, datë 27.11.2018), provizionet e institucioneve financiare për pjesën e mjeteve të dyshimta – rrezikut kreditor, konsiderohen shpenzime. Po ashtu, bazuar në “Rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor”, miratuar nga Bordi i BQK-së më 29 gusht 2013, si dhe “Rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor”, miratuar nga Bordi i BQK-së më 31 gusht 2016, institucionet financiare të licencuara nga BQK, obligohen që shpenzimet e tilla t’i pasqyrojnë në pasqyrat financiare në fund të vitit.

Institucionet financiare të licencuara nga BQK, për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për humbjet e pritura nga kreditë, në shumën e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejuar nga BQK.

Pas njohjes së provizioneve nga institucionet financiare të licencuara nga BQK, çdo shumë e zvogëluar si rezultat i pagesës nga arkëtimi i kredive të provizionuara ose përmirësimi i vlerësimit të rrezikut kreditor që rezulton në zvogëlimin e provizioneve, përfshihet në të ardhura të tatueshme, ndërsa çdo shumë e rritur në provizione deri në shumën e lejueshme, njihet shpenzim i zbritshëm.

Në rast se BQK kërkon korigjim të provizioneve të deklaruar sipas kritereve të mësipërme, ndryshimet e tilla duhet të rregullohen në deklaratë tatimore.

Shpenzimet për mjetet e dyshimta - rrezikut kreditor, duhet të shpalosen në mënyrë analitike, përfshirë kronologjinë e ndodhjes.

Shuma e vlerës së provizioneve për mjete të dyshimta – rrezikut kreditor në fund të vitit paraprak, konsiderohet gjendje fillestare e vitit vijues.

Me qëllim të harmonizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, për diferencën e krijuar, pavarësisht se a rezulton me zvogëlim apo rritje, kërkohet të bëhen rregullimet e nevojshme.

Data: 26/12/2018

Prishtinë

z. Sakip Imeri  
Zyja Qendrore  
Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së

